

Tel.: + 49 (20 1) 75 99 85 28  
Fax: + 49 (20 1) 75 99 85 29  
E-Mail: info@i-de-al.org  
Web: www.i-de-al.org

Amtsgericht: Essen VR 5251  
Steuernr.: 112/5870/1294

Bankverbindung: GLS Bank  
Kontonr.: 404 859 38 00  
BLZ: 430 609 67

Präsidentin: Anduena Stephan

Essen, 08 Dhjetor 2013

## IDEAL falenderon të gjithë Miqtë e DITËS së DIALOGUT!

Të nderuar Miq,

**IDEAL** - Shoqata Integrative Gjermano-Shqiptare - Ju falenderon për zemërsisht për prezencën, mbështetjen dhe kontributin Tuaj për realizimin me sukses të **DITËS** së **DIALOGUT** mes Landit të Rinit Verior dhe Vestfalisë (NRW) së Gjermanisë dhe Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë Perendimore.

**IDEAL** si një nga shoqatat më aktive të diasporës intelektuale shqiptare në këtë land të Gjermanisë, kurorëzoi me sukses nismën e saj për vendosjen e urave aktive të dialogut mes NRW dhe vendeve tona amë. Kjo ditë shërbeu për **nxitjen e bashkëpunimit** në fushën e **tregtisë** dhe **ekonomisë**, të **integritit** dhe **bashkëpunimit** ashtu si dhe në fushën e promovimit të **vlerave kulturore dhe historike të kombit tonë** dhe vendosi kapacitetet intelektuale shqiptare në diasporë në qendër të këtij bashkëpunimi.

**IDEAL** në bashkëpunim të ngushtë me **Ministritë e Ekonomisë dhe Tregtisë** së Landit dhe Shqipërisë, **Dhomat e Tregtisë** dhe Industrisë së Landit dhe të Tiranës, **Dhomës së Promovimit të Investimeve të Landit – NRW. International**, Agjencisë së Promovimit të Investimeve të Kosovës - **IPAK**, Organizatës gjermane të Bashkëpunimit Ndërkombëtar – **GIZ**, Qendrës Ndërkombëtare për Migracionin – **CIM**, do ta vazhdojë këtë nismë dhe do ta konkretizojë atë me aktivitete të tjera në muajt dhe vitet që do të pasojnë.

**DITË DIALOGU** e konceptuar si një bashkëbisedim i hapur mes **me shume se 160 pjesëmarrësve**, përfaqësues të **biznesit të madh, të**



**mesem dhe të vogël** gjerman dhe shqiptar, institucioneve më të rëndësishme gjermane si Ministria Federale e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit - **BMZ, Ministria e Jashtme Gjermane dhe Shqiptare** përmes Ambasadës Gjermane në Tiranë dhe asaj Shqiptare në Berlin, Ministrive të Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmarrjes së Landit, Shqiperise dhe Kosovës, **Ministrive të Turizmit, Ministrive të Bujqësisë** të Shqipërisë dhe Kosovës, **Bashkisë së Qytetit të Essenit**, përfaqësues të **diasporës** i dhane jetë ketij **DIALOGU**. **Ekspozita e produkteve dhe prodhimeve shqiptare** nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia Perëndimore, **ekspozita fotografike e kodikeve** të lashtë bizantinë shqiptarë e **Arkivit të Shtetit të Shqipërisë** shoqëruan këtë aktivitet gjatë gjithë ditës, për të kulminuar në një **mbrëmje gala** ku u interpretuan disa nga pjesët më të mira të muzikës sonë klasike, etnojazz dhe asaj bashkëkohore.

Për ne ishte kënaqësi e vecantë që **Kryeministri i Shqiperise Z. Edi Rama** e pershendeti këtë **DITË DIALOGU** personalisht dhe shprehu mbështetjen e tij dhe të Qeverisë që ai drejton për iniciativa të tilla, ndërsa personalitete të tjera si Zv. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmarrjes së Shqiperise **Znj. Brunilda Paskali, Dr. Günther Horzetzky**, Sekretar Shteti në Ministrinë e Ekonomisë, Energjisë, Industrisë, Biznesit të Mesëm dhe Zejtarisë në Landin NRW dhe **Z. Rudolf Jelinek**, Kryetar i 1-rë i Bashkisë së Qytetit të Essenit, Ambasadori i Republikës së Shqiperise në Berlin, **Z. Valter Ibrahim** na nderuan me prezencën e tyre në të.

**DITË DIALOGU** dha impulse të reja për **më shumë shkëmbime mes Gjermanisë dhe Shqipërisë e Kosovës**, sidomos në fushën e energjisë, industrisë, tregtisë, turizmit, transportit apo agrobiznesit. Në të njëjtën kohë, ky aktivitet i dha mundësinë diasporës të veprojë si një **urë lidhese** dhe të japë një **kontribut më të qëndrueshëm** për forcimin e vendit amë. Ne do të vazhdojmë këtë **DIALOG** dhe mbetemi konfidentë se së bashku me Ju do ta konkretizojmë shpejt këtë aktivitet me projekte të rëndësishme për të gjithë palët.

Në faqen tonë të internetit **www.i-de-al.org**, Ju mund të shijoni disa nga momentet më të bukura të kësaj dite si dhe të rigjeni dokumentacionin e plotë të konferencës si dhe pasqyrat e shtypit nga **Deutsche Welle, RTK, News24**, debatin në **Tonight Ilva Tare** në Ora News etc. mbi këtë event.



Edhe në këtë vit, **IDEAL** do të vazhdojë të intensifikojë **DIALOG**-un me Shqipërinë dhe Kosovën, ashtu sikurse premtuam dhe në mbyllje të konferencës.

Këto ditë **DIALOGU**-u nën moton „**NRW e ftuar në Shqipëri dhe Kosovë**“ do të mbahen nga data **3 - 7 Shtator 2014**. Edhe këto evente do të zhvillohen në bashkëpunim të ngushtë me **Ministrinë e Ekonomisë, Energjisë, Industrisë dhe Sipërmarrjes së mesme si dhe Profesioneve të Landit** të NRW, Agjensinë e Promovimit të Investimeve dhe Këmbimeve të Landit **NRW International, Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë** si dhe **Dhomat e Profesioneve. Sekretari i Shtetit** i kësaj Ministrie, **Dr. Günther Horzetzky** ka sinjalizuar ndërkohë pjesëmarrjen e tij në këto evente. Ne ju ftojmë të gjithëve të merrni pjesë në to. Programi i detajuar i këtyre **DITË DIALOGU** do t'ju dergohet në fund të Majit. Ndërkohë **Ju ftojmë të shënoni në kalendarin Tuaj këto data.**

**Juaja**

**IDEAL** - Shoqata Integrative Gjermano-S hqiptare

Anduena Stephan

**Presidente**

**Konsulle e Nderit e Republikës së Shqipërisë në NRW**

**Përfaqesuese e Dhomës së Tregtisë & Industrisë Tiranë për Landin e NRW, Gjermani**

